

## MINISTRI MANJA PREZANTON PRIORITETET E QEVERISË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT



Në Prokurorinë e Përgjithshme, në prani të Prokurorit të Përgjithshëm z. Olsian Çela si mikpritës dhe Drejtuesit të SPAK, z. Altin Dumani, u prezantuan prioritetet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024. Ministri Manja përgëzoi rezultatet e punës gjatë 2023, dhe prezantoi rekomandimet e luftës kundër kriminalitetit për vitin 2024 dhe i garatoi për bashkëpunimin dhe mbështetjen e pakushtëzuar të qeverisë shqiptare për zbatimin e kësaj strategjie, që rrit efikasitetin dhe besueshmërinë e reformës në drejtësi. Angazhimi ynë i përushtimin e ndjekjes penale dhe hetimin në pavarsësi të plotë, sipas kushtetutës dhe ligjtit qytetar të marrë drejtësinë që meriton në kohë!



## DOSJET E PRAPAMBETURA NË GJYKATA: MINISTRI MANJA TREGON MASAT E REJA!

Prezantohet Strategjia për Uljen e Çështjeve të Prapambetura në gjykata, një dokument që bashkoi aktorët kryesorë të sistemit të drejtësisë dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. U prezantuan masa konkrete për t'i dhënë fund problemit të dosjeve të pagjykuara. Si Ministër i Drejtësisë, Manja garantoj mbështetjen e pakushtëzuar të qeverisë shqiptare për zbatimin e kësaj strategjie, që rrit efikasitetin dhe besueshmërinë e reformës në drejtësi. Angazhimi ynë i përbashkët është kyç për të siguruar që çdo qytetar të marrë drejtësinë që meriton në kohë!

## KUVENDI MIRATON KONVENTËN E HAGËS PËR MARRËVESHJET PËR ZGJEDHJEN E GJYKATËS DHE PROTOKOLLIN PËR LIGJIN E ZBATUESHËM PËR DETYRIMET USHQIMORE

Miratohen në Kuvend me 98 vota pro dy projektligje: "Konventën e Hagës për Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës" dhe "Protokollin për Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet Ushqimore". Dy ligje që garantojnë universalitetin e të drejtës ndërkombëtare në të drejtën e brendshme, forcojnë sigurinë juridike për biznesin në marrëdhëniet tregtare ndërkombëtare, si dhe lehtësojnë procesin e dhënies së vendimeve për detyrimet ushqimore, në rastet që kanë të bëjnë me fëmijët në marrëdhëniet familjare.





## KUVENDI JEP "DRITËN JESHILE" PËR KONVENTËN "LUBJANË – HAGË TË NËNSHKRUAR NGA MINISTRI MANJA

Miratohet në Kuvendin e Shqipërisë me 92 vota prokonventa "Lubjanë – Hagë për Bashkëpunimin Ndërkontinentar për Hetimin dhe Ndjeçjen Penale të Krimit të Gjenocidit, Krimeve kundër Njerëzimit, Krimeve të Luftës dhe Krimeve të Tjera Ndërkontinentare", si një instrument më shumë për të luftuar pandëshkueshmërinë e krimeve ndërkontinentare. Kjo konventë është një garanci më shumë për thellimin e bashkëpunimit të agjencive tona ligjzbatuese me ato ndërkontinentare dhe një siguri që çdokush që ka kryer krime ndërkontinentare të mos ketë imunitet penal!



## MANJA TAKON BRITANIKËT: PROJEKTE TË REJA PËR SISTEMIN GJYQËSOR!

Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar po njeh zhvillime të reja pozitive! Takim produktiv me Ambasadorin britanik, Alastair King-Smith dhe delegacionin britanik të gjyqësorit, i kryesuar nga gjyqtari me eksperiencë, LJ Dingermans, ku u diskutua shkëmbimi i përvojave, mbështetja për reformën në drejtësi, forcimi i kapaciteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, digjitalizimi i sistemit të drejtësisë, si dhe trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve!



## MINISTRI MANJA "HAP DYERT" PËR EKSPERTIZËN FRANCEZE NË DREJTËSINË SHQIPTARE

Takim prezantues dhe pune me Drejtorin e Përgjithshëm të AFD-së, z. Jérémie Pellet dhe delegacionin që e shoqëronte. Franca, si vend mik dhe avokat e Shqipërisë në rrugëtimin e saj drejt BE-së, është e gatshme të ofrojë ekspertizën e saj në fusha me interes të përbashkët si: Drejtësia mjedisore, Digjitalizim, Trajinim i vazhdueshëm i magjistratëve tanë me legjislacionin e BE-së, Ekspertizë për krimin kibernetik, Fuqizimi i kapaciteteve tona njerëzore për Ndihmën Juridike Falas, Parandalimi i krimeve për të miturit. Falë marrëdhënieve të shkëlqyera ndërmjet dy vendeve dhe vullnetit të përbashkët politik, ky bashkëpunimi do të kornizohet edhe me një marrëveshje bashkëpunimi në të ardhmen e afërt!

